

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6495
E enjte, 23 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Evropa rikthen masat kufizuese për luftim të pandemisë FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA PO "ZHYTET" NË KRIZË TË THELLË ENERGJETIKE! FAQE 4-5

PAS SHUMË VITESH DRITË, RIKTHEHEN SHKURTIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE



Nga sot (e enjte) do të rikthehen shkurtimet e energjisë elektrike në Kosovë. Pas një kohe të gjatë të pamungesës, qytetarët e Kosovës do të përballen me nga dy orë mungesë energji elektrike në ditë. Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se kohëzgjatja e këtyre shkurtimeve do të varet nga instruksionet që do t'i japë KOSTT-i. Paralajmërimi i mungesës së energjisë elektrike ka nxitur kundërshtime të ashpra në vend

OPINION

PARASHIKIMI METEO-POLITIK: 2022 F.7

Shkruan:
Blerim REKA



AKTUALE



ARRESTOHEN TRE PERSONA PËR FALSIFIKIM TË DOKUMENTEVE NË AEROPORTIN E PRISHTINËS F.6

TAHIRI: KOSOVA NË 'OPEN BALLKAN', KUR TË NA NJOHË SERBIA F.7

EKONOMI



SYTË KAH DANIMARKA PËR DEKARBONIZIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE F.8

SPORT



DISTRIA KRASHNIQI DHE NORA GJAKOVA, TË PARAT NË RANGLISTËN BOTËRORE F.10

MSh-ja, qytetarëve: Merrini të gjitha dozat e rekomanduara të vaksinës! FAQE 5



DEPUTETËT MARRIN PAGA TË PLOTA PËR PJESËMARRJE TË ZBEHTË NË KUVEND FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Evropa rikthen masat kufizuese për luftim të pandemisë

BRUKSEL, 22 DHJETOR - Liderët evropianë kanë rikthyer kufizimet për ta luftuar pandeminë e koronavirusit tek varianti "Omicron" vazhdon të përhapet nëpër kontinent. Gjermania dhe Portugalia janë në mesin e shteteve që kanë njoftuar për kufizime pas festës së Krishtlindjes.

"Omicron"-i tashmë është variant dominues në shumë vende të Evropës.

Hans Kluge nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se vala e re e infektimit do t'i

përballë me vështirësi sistemet shëndetësore. Sipas tij, "një tjetër stuhi" është duke ardhur dhe qeveritë duhet të bëhen gati për rritje të konsiderueshme të infektiveve.

Gjermania ka bërë me dije se nga 28 dhjetori do t'i kufizojë organizimet private në deri 10 persona dhe klubet e natës do të mbyllën. "Koronavirusi nuk ka pushim për Krishtlindje", ka thënë kancelari gjerman Olaf Scholz të martën.

Portugalia do t'i mbyllë baret dhe klubet e natës nga 26 dhjetori,

derisa punën nga shtëpia do të bëjë të obligueshme deri më 9 janar.

Në Finlandë baret dhe restorantet do të mbyllën në orën 22:00 nga 24 dhjetori.

Në Suedi, baret, kafiteritë dhe restorantet do të mund t'u shërbejnë vetëm konsumatorëve të ulur dhe njerëzve u është kërkuar të punojnë nga shtëpia.

Prej shpërthimit të pandemisë, Evropa ka regjistruar më shumë se 89 milionë raste të infektimit me koronavirus. Prej tyre, 1.5 milion persona kanë vdekur.



Putini, letër Vuçiqit: Llogaris në bashkëpunim të ngushtë

MOSKË, 22 DHJETOR - Në një letër dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se llogarit në "vazhdimin e një dialogu konstruktiv me të" dhe në "bashkëpunim të ngushtë për çështje aktuale të agjendës dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare".

Letrën e Putinit, drejtuar Vuçiqit, e dorëzoi ambasadori rus në Serbi, Aleksandr Bochan Kharchenko, në një takim të mbajtur të mërkurën në Presidencën e Serbisë. "Dialogu



midis Rusisë dhe Serbisë themelore të popujve korrespondon me interesat vëllazërorë dhe kontribuon në

stabilitetin dhe sigurinë në kontinentin evropian", shkroi Putini në letër, transmeton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë.

Putini, po ashtu, tha se bisedimet e tij me Vuçiqin në Soçi të Rusisë "konfirmuan plotësisht forcën e partneritetit strategjik midis Rusisë dhe Serbisë".

Vuçiqi dhe Putini u takuan në Soçi më 25 nëntor për të diskutuar për furnizimet me gaz në Serbi, për Kosovën dhe për çështje të tjera dypalëshe.

Në këtë takim u ra dakord për uljen e çmimit të gazit rus për Serbinë dhe për rritjen e importeve. Vuçiqi u takua me Putinin edhe në qershor të vitit 2020, kur ai mori pjesë në një paradë ushtarake në Moskë.

Pikërisht për shkak të bashkëpunimit me Rusinë, Serbia është në shënjestër të kritikave nga Perëndimi, sepse si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ajo nuk e ka harmonizuar ende politikën e saj të jashtme me atë evropiane.

Lira turke vazhdon të stabilizohet

ANKARA, 22 DHJETOR - Lira turke ka vazhduar të stabilizohet më 22 dhjetor, pas zhvlerësimit në nivele rekorde javë më parë.

Rimëkëmbja e monedhës turke është rezultat i masave të paraqitura nga presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan më 20 dhjetor.

Erdogani ka thënë se plani i tij parasheh mbrojtjen e kursimeve në lira, pavarësisht prej lëkundjeve të tregut.

Lira është shitur 12.25 kundrejt dollarit amerikan, për dallim nga 18.36 sa kishte arritur më 20 dhjetor.

Erdogani ka thënë se qeveria do t'i mbulojë humbjet e shkaktuara të personave që i kanë kursimet në lira në momentin kur zhvlerësimi i monedhës turke kundrejt valutave të huaja tejkalon normat e interesit të bankave. Zhvlerësimi i lirës ka ndikuar në

rritje të çmimeve, ndërkohë që shumë turq kanë shitur lirat e tyre për monedha të tjera, apo kanë blerë ar për t'i siguruar kursimet.

Erdogani nuk ka bërë me dije si do ta mbulojë qeveria këtë plan. Ekspertët financiarë kanë thënë se nëse vlera e lirës bie sërish dhe detyron qeverinë t'i mbulojë humbjet, kjo situatë mund të çojë në rritje të inflacionit dhe deficitit.



Pendarovski: "Në Bashkimin Evropian, jo si pema pa rrënjë"



SHKUP, 22 DHJETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, në fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit, më 22 dhjetor, tha se nuk duhet nxituar në zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë pasi, sipas tij, nxitimi "nuk është gjithmonë aleati më i mirë". "Në vend të kësaj, duhet të punojmë në

reformat kyçe në vend nga të cilat varet cilësia e jetës së qytetarëve tanë", u shpreh Pendarovski.

Ai tha se tezat se status quo-ja e zgjatur mund ta shkaktojë destabilizimin e sigurisë së vendit nuk qëndrojnë dhe se në BE nuk duhet të hyhet si "një pemë pa rrënjë".

"...Në kontekstin aktual, kur i

njohim vijat tona të kuqe dhe i mbrojmë ato publikisht, nuk duhet të jemi të preokupuar se sa kohë do të duhet që të tjerët të përballen me të vërtetën për ne... Shtetet me zhvillim unik socio-kulturor janë anëtarë të BE-së, e jo ato që shkojnë atje si asnjë vend tjetër, si një pemë pa rrënjë", tha Pendarovski.



DEPUTETËT MARRIN PAGA TË PLOTA PËR PJESËMARRJE TË ZBEHTË NË KUVEND

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Mungesa e deputetëve në seancat e Kuvendit të Kosovës duhet të sanksionohet me reduktim të pagës dhe ndalim të kompensimeve financiare që marrin për pjesëmarrje në aktivitete të tjera, thonë mbikëqyrës të punës së tyre. Ata thonë se gjatë legjislaturës aktuale, e cila është konstituuar më 22 mars, është vërejtur mungesë e theksuar e deputetëve në punimet e Kuvendit. Për këtë ka reaguar edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. Në seancën e 19 nëntorit, Konjufca ka thënë se “deputetët duhet të jenë në seancë”, sepse

“paguhen nga populli”. Në këtë ditë në seancë ishin të pranishëm 59 nga 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës. Paga bazë e një deputeti në Kosovë është 1 547 euro në vit. Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seanca plenare është 240 euro, ndërsa kompensimi për mbledhje të komisioneve është 160 euro. Të 120 deputetët kanë edhe të drejtën e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit dhe udhëtimit brenda dhe jashtë vendit me detyra zyrtare. Në formularët e deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës thuhet se

deputetët marrin deri në 23 mijë euro pagë vjetore dhe kompensime të tjera. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, për t'i përfutur këto të ardhura deputeti është i detyruar të marrë pjesë në seancat plenare dhe në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit në të cilat është anëtar.

Shamolli: Kompensime të panevojshme

Naser Shamolli, nga Grupi për Studime Juridike, thotë se rregullorja, sa iu përket kompensimeve shtesë, duhet të

rishikohet. Sipas tij, paga e deputetit duhet të jetë e mjaftueshme. “Qasja në kompensime shtesë për pjesëmarrje në seanca dhe në trupat e Kuvendit, siç janë komisionet, është e diskutueshme, pasi ata marrin një pagë bazë për funksionin e deputetit. Prandaj, në të ardhmen duhet të shikohet që këso lloje kompensimesh të mos lejohen më”, thotë Shamolli për “Radion Evropa e Lirë”.

Agnesa Haxhiu, hulumtuese e politikave në Institutin Demokratik të Kosovës, thotë se është duke u punuar në një rregullore të re të punës së Kuvendit, e cila parasheh sanksione financiare për deputetët që mungojnë pa arsye në seanca.

Instituti Demokratik i Kosovës merr pjesë në grupet punuese që i hartojnë rregulloret për Kuvendin e Kosovës dhe, në raste të caktuara, bën rekomandime. “Këto sanksione [do të] vijnë për ta ngritur përgjegjësinë e deputetëve karshi detyrave dhe përgjegjësi që i kanë, duke filluar me pjesëmarrjen e rregullt në punime të seancës”, thotë Haxhiu për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas saj, Instituti Demokratik i

Kosovës, po ashtu, kërkon që pjesëmarrja e deputetëve të monitorohet deri në përfundimin e seancës. “Administrata e Kuvendit e bën regjistrimin e deputetëve vetëm në fillim të seancës, por nuk e bën regjistrimin gjatë kohës sa zgjat seanca. Seanca mund të zgjasë tërë ditën dhe normalisht që deputetët lëvizin. Ka shumë raste kur deputetët janë nënshkruar në fillim dhe nuk kanë qëndruar sa ka zgatur seanca dhe është konsideruar se ata kanë qenë të pranishëm në seancë”, thotë Haxhiu. Megjithatë, Zyra për Informim e Kuvendit të Kosovës thotë se për çdo mospjesëmarrje në seancë plenare deputetit i ndalet paga në mënyrë proporcionale me seancat e mbajtura. Po ashtu, kompensimi i mjeteve për pjesëmarrje në komisione thuhet se bëhet vetëm nëse deputeti merr pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit të caktuar.

Që nga 22 marsi, kur është konstituuar legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës dhe kur është miratuar agenda legjislative e qeverisë e deri më tani, 23 ligje janë miratuar dhe 86 mbeten në procedurë. Mungesa e kuorumit është përmendur shpesh si pengesë për moskalimin e ligjeve.

Miratohet në parim Projektligji për reformimin e ndihmës sociale, ndahen 47 milionë euro kredi

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka miratuar në parim Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së financimit në mes të Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) për projektin “Projekti i reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë”. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se vlera e këtij projekti

është 47 milionë euro dhe si marrëveshje do t'i mundësojë qeverisë që ta përmirësojë efikasitetin e reformës së sistemit të ndihmës sociale. “Me qëllim të projektimit të asistencës sociale të familjeve në nevojë, ne si ministri kemi nënshkruar marrëveshjen për financimin e këtij projekti. Vlera totale e projektit pritet të jetë 47 milionë euro dhe i mundëson Qeverisë së Kosovës ta përmirësojë

efikasitetin e sistemit të asistencës sociale, ku përmes testit të varfërisë do të synohen më mirë mjetet që shkojnë për asistencë sociale”, ka deklaruar Murati.

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kërkuar që të dijë se ku shkojnë këto mjete, derisa ka thënë se më herët janë marrë kredi për investime kapitale dhe tashmë po merret për financimin e skemave sociale.





KOSOVA PO ZHYTET NË NJË KRIZË TË THELLË ENERJETIKE

Pas shumë vitesh rikthehen reduktimet e energjisë elektrike

Nga sot (e enjte) do të rikthehen reduktimet e energjisë elektrike në Kosovë. Pas një kohe të gjatë, qytetarët e Kosovës do të përballen me nga dy orë mungesë energji elektrike në ditë. Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se kohëzgjatja e këtyre reduktimeve do të varet nga instruksionet që do t'i japë KOSTT-i. Paralajmërimi i mungesës së energjisë elektrike ka nxitur kundërshtime të ashpra në vend

Paralajmërimet për shkurtime nxitin reagime

Paralajmërimi i rikthimit të shkurtimeve të energjisë ka nxitur reagime të shumta në Kosovë.

Partia Socialdemokrate (PSD) ka organizuar të mërkurën edhe protestë para Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), duke kundërshtuar vendimin e qeverisë për ndarjen e mjeteve për blerje të energjisë. Përveç thasëve të mbushur me kartemonedha false në vlerë 500 euro, aktivistët e kësaj partie kanë vendosur edhe një "çek" në vlerë prej 20 milionë eurosh si shenjë proteste ndaj qeverisë që ndau mjete për t'i paguar shpenzimet shtesë për import të rrymës.

Me këtë rast, kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, se në këtë fushë janë bërë dy krime të rënda. "Të gjithë jemi dëshmitarë të një krimi që ka ndodhur vite më herët. Ai krim po përsëritet me krim të radhës tani. I pari ishte shitja e rrjetit të distribucionit për 26 milionë euro. Është bërë si shitje që do të sigurojë investime në rrjet, çmime më të mira e të përballueshme dhe furnizim 24 orë me rrymë. Siç e dini, kjo qeveri që sot është në

pushtet ka qenë ndër kritikueset më të mëdha të këtij procesi. Kjo sot ka bërë krim të radhës, shumë të fuqishëm, ndoshta edhe më i madh se i mëparshmi, sepse ka bërë dy veprime", ka thënë Molliqaj, duke shtuar se qeveria Kurti ka legjitimuar krimin e mëhershëm. "Së pari e ka legjitimuar krimin e parë duke e financuar e, së dyti, duke i detyruar qytetarët e Kosovës të paguajnë dy herë për energjinë e njëjtë. Qeveria i ka ndarë 20 milionë euro KEK-ut për të blerë rrymë, do t'ia shesë KESCO-s e KESCO KEDS-it, e çmimi që blihet nga KEDS-i në KEK është rreth 30 euro megavati e shitet rreth 80 euro. Pra, qytetarët do të paguajnë dy herë këtë energji elektrike. Një herë me taksat përmes qeverisë, herën e dytë përmes faturave", ka thënë Molliqaj.

Kurse shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se çështja e mungesës së rrymës do të diskutohet në Kuvend. "S'duhet të ketë ngritje të çmimit të rrymës. Për këtë etëm do të kërkohet në debatin parlamentar këtë të premte. Çdo ditë e më shumë Kosova dhe qytetarët e saj po përballen me mungesë të energjisë elektrike, njëkohësisht me paralajmërimet e qeverisë për rritjen e çmimit të rrymës", ka shkruar Tahiri në

profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, të premten deputetët do të diskutojnë për këtë temë. "Lidhur me këtë temë cruciale për jetesë të qytetarëve të vendit, si grup parlamentar dhe me kërkesë të kryetarit Haradinaj, në kryesinë e Kuvendit kemi shtruar kërkesën për debat parlamentar lidhur me problemin e energjisë elektrike. Pra, në seancën e së premtes do ta kemi debatin për çështjen e energjisë elektrike", është shprehur ai.

Kosova është duke u përballur me një krizë energjetike pasi që prodhimi vendor nuk po arrin ta mbulojë të gjithë nevojën për konsum.

KEDS-i është i detyruar ta importojë energjinë elektrike nga vendet e tjera, në një kohë kur çmimi i rrymës në këto tregje është shumëfishuar.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë tani është duke e shqyrtuar kërkesën e KEDS-it për shtrenjtim të rrymës deri në 7 për qind.

Konsumatorët e Kosovës aktualisht paguajnë 6.75 centë për kilovat në orë.

Ky çmim do të jetë deri më 1 prill të vitit 2022, nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në Kosovë nuk aprovon kërkesën e KEDS-it për rritje të çmimit të energjisë elektrike.

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Pas një dekade në Kosovë do të rikthehen reduktimet e energjisë elektrike. Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se nga sot (e enjte) qytetarët e Kosovës do të përballen me nga dy orë mungesë energji elektrike në ditë. Sipas KEDS-it, këto reduktime do t'i prekin të gjithë qytetarët e Kosovës. "Gjatë ditëve të fundit sistemi elektroenergetik i vendit është mbingarkuar tej mase. Në të njëjtën kohë, duke u ballafaquar me krizën më të rëndë elektroenergetike botërore, Operatori i Tregut-KOSTT, duke u bazuar në ligjet në fuqi, ka udhëzuar që të fillohet me kufizime të energjisë elektrike. Këto kufizime do të jenë rreth dy orë dhe do të prekin të gjithë

konsumatorët në kohë të ndryshme, përveç atyre emergjentë", është thënë në komunikatën e kësaj kompanie. KEDS-i ka lënë të kuptohet se kohëzgjatja e këtyre reduktimeve do të varet nga instruksionet që do t'i japë KOSTT-i. "Kjo situatë do të mbizotërojë gjatë 24 orëve të ardhshme, ndërsa për ditët në vijim në jemi në pritje të instruksioneve nga KOSTT-i dhe do të veprojmë konformë tyre. Sistemi elektroenergetik i vendit është afektuar tashmë komplet nga kriza globale dhe pasojat e saj përballohen më lehtë nëse secili nga ne jep kontributin e tij. Pra, që kriza të ketë ndikim sa më të vogël, KEDS-i apelon për kursim maksimal të energjisë elektrike dhe përdorim të formave alternative të ngrohjes aty ku ka mundësi", është thënë në komunikatën për medie.

MSh-ja, qytetarëve: Merrini të gjitha dozat e rekomanduara të vaksinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit në Kosovë janë regjistruar 20 raste të reja me Covid pas testimit të 1 870 mostrave. Në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë, i cili i referohet raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), thuhet se në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 12 pacientë, kurse janë edhe 322 raste aktive.

Në 24 orët paraprake janë dhënë 2 074 doza të vaksinave kundër Covidit.

Prej fundit të marsit, kur nisi fushata e imunizimit e deri më 22 dhjetor, në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 778 403 qytetarë. Ndërkaq, që prej fillimit të dhjetorit, personat mbi 18 vjeç mund t'i marrin edhe dozat përforcuese dhe ato të treta të vaksinës.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës

(ShSKUK) në trajtim mjekësor janë 42 pacientë, 11 pacientë të konfirmuar me Covid-19, 31 post-Covid.

Nga numri i përgjithshëm të pacientëve, 10 pacientë janë me oksigjeno-terapi, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka pacientë.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka njoftuar të mërkurën se personat të cilët marrin dozën përforcuese të vaksinës Covid-19 ose edhe dozën e parë ose të dytën, gjithashtu rekomandohet ta marrin edhe vaksinën e gripit sezonal.

IKShPK-ja ka theksuar se meqenëse Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar sezon shumë më agresiv të gripit sezonal 2021/2022, atëherë MSh-ja ka siguruar doza të gripit sezonal në sasi të mjaftueshme që situata epidemiologjike të jetë sa më e mirë.

Vaksinimi kundër Covid-19 ka parandaluar të paktën 469 mijë vdekje të moshës 60 vjeç e më lart në Evropë, sipas studimit të përbashkët të Zyrës së



Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) në Evropë dhe Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC).

Kështu është bërë me dije ditë më parë sipas një studimi të publikuar në revistën shkencore

“Eurosurveillance”, i kryer në 33 vende të Evropës.

Studiuesit, duke përdorur numrat javorë të vdekjeve të raportuara në grupmoshë, llogaritën se sa njerëz do të kishin vdekur pa vakcina dhe më pas i krahasuan këto parashikime

me humbjet e jetëve në periudhën dhjetor 2020 - dhjetor 2021. Sipas tyre, pa vaksinim ky numër në Evropë do të dyfishohej. “Merrini të gjitha dozat e rekomanduara të vaksinës”, është bërë me dije në njoftimin e MSh-së.

Sekuestrohen 1 000 kilogramë duhan



PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Njësia e Task Forcës e Policisë Kufitare (DRK-Lindje), në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë, ka shtuar kontrollat taktike dhe operacionale në terren. Si rezultat i tyre, të mërkurën rreth orës 11:20, bazuar edhe në

analizën e riskut dhe informacioneve inteligjente të bëra nga ana e njësive të policisë kufitare, është arritur të identifikohet furgoni Wolfsburg LT, ngjyrë e bardhë, me targa vendore, drejtuar nga i dyshuari me iniciale (S. S.), shtetas i Kosovës, i cili ishte futur në

territorin e Republikës së Kosovës nga Republika e Maqedonisë Veriore përmes rrugëve ilegale.

Pas tentativës së tij për t'iu shmangur ndalimit policor dhe futjes së tij në zonë urbane në qytetin e Vitisë dhe tentimit të arratisjes së bashku me mallin,

autoritetet kufitare kanë arritur ta ndalojnë të dyshuarin rreth orës 13:35 në afërsi të tregut të gjelbër.

Gjatë kontrollit janë gjetur 36 thasë duhan të papërpunuar, rreth 1 000 kilogramë.

Me këtë rast është duke u marrë Njësia e Hetimeve Rajonale e

Drejtorisë Kufitare Lindje dhe vendimet e mëtejme do të ndërmerren në konsultim me prokurorin.

Pas hetimeve preliminare, në bashkëpunim me prokurorinë përkatëse, malli i konfiskuar do t'u dorëzohet Doganave të Kosovës.

Arrestohen tre persona për falsifikim të dokumenteve në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Autoritetet policore në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ANP "Adem Jashari" gjatë kontrollit dhe verifikimit të dokumenteve për kalimin e kufirit, respektivisht për udhëtim jashtë Republikës së

Kosovës, në tri raste kanë hasur në tre persona të dyshuar të cilët, nën dyshimin për falsifikim të dokumenteve (lejeqëndrim, vizë dhe pasaportë), janë ndaluar dhe arrestuar nga autoritetet kufitare të Kosovës.

Lidhur me çështjen është njoftuar prokurori kompetent. Me urdhër të tij janë iniciuar rastet, ndërsa tre personat e dyshuar pas arrestimit janë dërguar në mbajtje për procedura të mëtejme hetimore.

Autoritetet e Policisë së Kosovës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës kanë theksuar se janë të përkushtuara për menaxhimin efikas dhe efektiv të kufirit shtetëror sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare.



30 gra ndërmarrëse të Gjilanit përfitojnë pajisje eficiente në vlerë prej 3 000 eurosh

GJILAN, 22 DHJETOR (ER) - Tridhjetë grave të Gjilanit u janë shpërndarë të mërkurën kontratat si përfituese të granteve nga Millenium Foundation Kosova, Hepl Kosova, në bashkëfinancim me Komunën e Gjilanit, në kuadër të programit "Gratë ndërmarrëse në energji". Gratë ndërmarrëse kanë

përfituar grante në formë të pajisjeve eficiente (që nuk shpenzojnë shumë rrymë) në vlerë prej 3 000 eurosh secila, derisa përfituese kanë qenë kryesisht ato në fushën e rrobaqepësisë.

Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka falënderuar nga Millenium Foundation Kosova

dhe Hepl Kosova për mbështetjen dhënë grave ndërmarrëse. "Për mua është shumë me rëndësi që t'u qëndrojmë afër ndërmarrësve, në këtë rast grave ndërmarrëse. Ne jemi zotuar që në kuadër të qeverisjes sonë, pjesëmarrja e grave o të jetë më e madhe sesa ka qenë më herët. Zotimi publik

ka qenë 40 për qind, derisa synojmë edhe 50 për qind. Personalisht besoj shumë në aftësitë dhe në intuitën e natyrshme të grave për të qenë më të përgjegjshme dhe më të zonja në punë", ka thënë kreu i Gjilanit, Alban Hyseni. Marrëveshja trepalëshe për këtë projekt është nënshkruar në

muajin shkurt, ndërsa janë zhvilluar dy sesione dëgjimore deri në procedurat e aplikimit.

Në kuadër të këtij projekti gratë ndërmarrëse në energji do të përfitojnë edhe trajnime në fushën e biznesit, bazat e kontabilitetit, në marketing, derisa rrobaqepëset do të zhvillojnë trajnim profesional të fushës.



Liridon Kastrati zgjedhet kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës



KAMENICË, 22 DHJETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Kamenicës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën ka zgjedhur kryesuesin komunal. Pas procesit të votimit me 18 vota për, Liridon Kastrati u zgjodh kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës. Kryesuesi Liridon Kastrati, duke falënderuar të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal, kryetarin e

komunës, Kadri Rahimaj, si dhe të gjithë qytetarët e Kamenicës, ka thënë se është mirënjohës që ia kanë besuar detyrën që ta kryejë funksionin e kryesuesit të Kuvendit. "Zotohem se me përgjegjësi të plotë do të bashkëpunoj ngushtë me të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal pa dallime politike, me qëllim që nevojat dhe kërkesat e

qytetarëve të gjejnë mbështetje të plotë nga ky Kuvend dhe ne së bashku me kryetarin z. Kadri Rahimaj do të angazhohemi që t'i shtyjmë përpara të gjitha proceset e nevojshme për komunën tonë. Andaj përkushtimi im do të jetë maksimal për t'i shërbyer këtij Kuvendi dhe qytetarëve tanë", ka thënë ai.

Profesoresha Jehona Lushaku-Sadriu i bashkohet LDK-së

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Profesoresha Jehona Lushaku-Sadriu i është bashkuar të mërkurën Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Lajmin e ka bërë me dije kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. "Ajo i bashkohet familjes sonë politike në

rrugëtimin e përbashkët që na pret përpara. Jehona është ligjëruese në Universitetin e Prishtinës në Departamentin e Shkencës Politike. Ajo ka mbaruar studimet e doktoratës në Universitetin e Hanoverit në Gjermani me temë 'Evropianizimi përmes

kushtëzimit dhe deliberimit' si dhe studimet postdiplomike në fushën e integriteteve evropiane në Qendrën 'Jean Monnet' në Universitetin e Hanoverit, po ashtu në Gjermani", ka shkruar Abdixhiku në llogarinë e vet në "Facebook".



Parashikimi meteo-politik: 2022

Shkruan: Blerim REKA

1. Bota po hyn në vitin e tretë të pandemisë, me kufizime të reja, kundër "armikut" të vjetër. Me restriksione në energji e me rrymë më të shtrenjtë. Kush do të besonte se në shekullin e inteligjencës artificiale do të përballeshim me mungesë vaksinash e me rrymë të pamjaftueshme?

Post-industrializmi nuk do të vijë aq shpejt sa pritej. Masat dekarbonizuese do të vonojnë e ngrohja globale do të vazhdojë.

2. Në vitin 2022 gjeopolitika e vaksinave dhe e energjisë do të dominojnë në agjendën globale. Shiringat dhe kilovatët do t'i përcaktojnë prioritetet qeveritare e do t'i ngarkojnë buxhetet shtetërore. Kina do të mbetet e varur energjetikisht nga Rusia, kurse Perëndimi syçelë ndaj "Jaltës

së re". ShBA-ja nuk do të lejojë një bosht lindor të ri, të luftës së ftohtë të vjetër. Uashingtoni do t'i kundërvihet globalisht autoritarizmit, me diplomaci të mbështetur me forcë. Pacifiku do të mbetet prioritet i tij, por paqja midis dy Koreve nuk do të arrihet, e as Tajvani nuk do të pushtohet nga Kina. Indo-Pacifiku do të mbetet arenë e përplasjeve globale, por Ukraina mund ta rikthejë radarin amerikan në Evropë. NATO-ja do t'i rikthehet misionit të vet origjinal: mbrojtjes së Evropës nga Moska, sidomos kur kërcimet ruse po zbresin nga Baltiku në Ballkan. Kjo strategji ruso-kineze për ta lodhur ShBA-në njëkohësisht në dy fronte: në Lindjen e largët (përballë Kinës) dhe në Evropë (karshi Rusisë), do të dështojë. Erërat e ftohta verilindore nga Siberia e Manxhurija nuk do ta përballojnë stuhinë perëndimore atlantike.

3. BE-ja do ta vazhdojë debatin për të ardhmen e vet, me "busollën strategjike", por pa diplomaci unike. "Kuajt e Trojës", që i ka brenda, do t'i bllokojnë reagimet më të ashpra ndaj sfidave lindore. Vështirë se Brukseli do të imponohet si faktor global, duke mbetur gjigant ekonomik e xhuxh ushtarak. "Armata evropiane" dhe "Sovraniteti evropian" nuk ka gjasa të jetësohen nga ideatori i tyre Makron. Në gjysmën e parë të vitit të ri, Franca vërtet do ta kryesojë BE-në, por edhe vetë presidenti i saj në pranverë do të sprovohet në zgjedhjet presidenciale. Nëse nuk rizgjidhet, e pas shkuarjes së Merkelit, BE-ja do të mbetet pa lider. Pos, ndoshta, teknokratit italian Dragi? Pa lidhshmëri, me veto në vendimmarrje, e me përplasjet midis sovranistëve dhe unionistëve, BE-ja do të përballet me krizë kredibiliteti. Edhe në vitin

e debatit për të ardhmen e Evropës, mjegulla tradicionale evropiane do të vazhdojë ta mbulojë kontinentin e vjetër.

4. Në vitin që vjen, fjala "zgjerim" do të përdoret gjithnjë e më rrallë, e "partneriteti" mund ta zëvendësojë "anëtarësimin". Politika e zgjerimit e BE-së (për 6 shtetet ballkanike) ka rrezik të rrëshqasë në politikën e "Partneritetit Lindor" (për 6 shtetet e Kaukazit). Këtyre të fundit as që iu ofrua anëtarësimi, e atyre të parave po, por u lanë vetëm në "perspektivën evropiane". Ballkanasit do të vazhdojnë të presin para dyerve të BE-së, sa nga shkaku i burokratëve të atjeshëm, po aq edhe nga riciklimi i elitave të korruptuara shtetërore. Shiu tradicional i Brukselit do ta mbulojë rajonin edhe në vitin tjetër.

5. Atë që nuk e bëri BE-ja, e bën ShBA-ja, pa të cilën edhe nuk zgjidhet asgjë në Ballkan. "Lista e

zezë" e thesarit amerikan do të zgjerohet në vitin që vjen, duke shkaktuar dridhje tektonike anti-korruptive në rajon. Bosët rajonalë u bënë kërcënim për interesin nacional amerikan. Korrupsioni strategjik nuk është mito e rryshfet, por rrëshqitje e rrezikshme e rajonit drejt skllavërisë energjetike ruse dhe robërisë kreditore kineze. Emërimi i hetuesit amerikan për korrupsionin ballkanik paralajmëron stuhi dimërore - përmbysëse ndaj baronëve ballkanikë.

6. Sanksionet kundër qeverisjeve autokratike do ta zëvendësojnë tolerancën tridekadëshe stabilokratike. Perëndimi nuk do t'i tolerojë më shtete private e as liderë të paprekshëm ballkanikë. Parashikimi meteo-politik thotë se pas fjollave të para të këtij dhjetori, bora do të shpeshetohet në fillim të vitit të ri, drejt një orteku anti-autokratik.



Tahiri: Kosova në 'Open Ballkan', kur të na njohë Serbia



PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka folur për iniciativën "Open Ballkan". Ai ka thënë se Kosova nuk duhet të marrë pjesë në këtë nismë, ngaqë është vend i pavarur dhe nuk ka nevojë për avokat. "Kosova mund të bëhet pjesë e 'Open Ballkan' kur ta njohë

Serbia. Çfarëdo tentativë tjetër për ta vendosur Kosovën në një diskurs tjetër kur nuk ka qartësi. Është gabim", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se iniciativat e Kosovës duhet të jenë në një drejtim: qëndrueshmëri në kërkesat tona në anëtarësim në NATO; qëndrueshmëri dhe strategji të saktë në raport me integrimin

evropian dhe kërkesë për të qenë vend kandidat, si dhe tutje njohjet nga pesë vendet e BE-së. "Çfarëdo iniciativë tjetër është mundësi e mirë vetëm për një fotografi, por nuk ka asnjë efekt pozitiv për Kosovën dhe për marrëdhëniet bilaterale apo rajonale që Kosova dëshiron t'i ndërtojë me vendet e tjera. Ne jemi të pavarur, nuk kemi

nevojë për avokatë, kemi nevojë për miq, por nuk kemi nevojë të hyjmë në iniciativa të cilat nuk na sjellin asnjë të mirë, veçse ngritin dilema, që tashmë e shumë vjet, Serbia i synon përmes iniciativave rajonale dhe elementeve të tjera që i ka shfrytëzuar në tryezat e bashkëpunimit rajonal", ka thënë Tahiri.

Ambasadori Berishaj dorëzoi letrat kredenciale te presidenti kroat, Zoran Milanović

Zagreb, 22 dhjetor (ER) - Ambasadori i Republikës së Kosovës, Martin Berishaj, ka dorëzuar të mërkurën letrat

kredenciale te presidenti i Republikës së Kroacisë, Zoran Milanović. Ambasadori Berishaj pritet të ndikojë në

përparimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Kroacisë. Martin Berishaj, vlerësohet,

ndër të tjera, edhe si njohës i mirë i diplomacisë, rrjedhimisht i marrëdhënieve diplomatike.



Sytë kah Danimarka për dekarbonizimin e energjisë elektrike



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Qeveria e Kosovës synon që përmes një marrëveshjeje me Mbretërinë e Danimarkës të përfitojë së paku 30 milionë euro investime në projekte që do të gjeneronin rrymë nga burime të ripërtërishme të energjisë. Lidhur me këtë, Ministria e Ekonomisë e Kosovës nënshkroi të hënën një letër-pëlqim me ministrinë homologe të Danimarkës. Për të hyrë në fuqi, marrëveshja duhet të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës me dy të tretat e votave të deputetëve.

Qeveria e Kosovës e konsideron ndihmën e Danimarkës të domosdoshme për "tranzicionin energjetik", por kritika për mostransparencë lidhur me letër-pëlqimin japin opozita dhe ekspertë të fushës së energjetikës.

Letër-pëlqimi thekson se, nëse marrëveshja hyn në fuqi, "Qeveria e Danimarkës synon të mbështesë programe relevante dhe projekte [në lidhje me shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë] deri në 30 milionë euro, në një periudhë fillestare prej pesë vjetësh". "Derisa fokusi kryesor pritet të jetë në tranzicionin e gjelbër, deri në 2 milionë e 500 mijë euro pritet të dedikohen

për projektet që promovojnë sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut", thuhet në letër.

Pa dhënë shumë hollësi të tjera lidhur me të, ministrja e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, tha të hënën se ky investim do të jetë i nevojshëm për realizimin e Strategjisë së Kosovës për Energjinë - dokument në të cilin Qeveria e Kosovës është duke punuar aktualisht. "Sektori i energjisë përballlet me sfida të shumta dhe kjo krizë e fundit energjetike na ka treguar edhe një herë brishtësinë e sistemit të energjisë. Synojmë që deri në vitin 2050 ta dekarbonizojmë sektorin e energjisë", tha Rizvanolli.

Burime të ripërtërishme të prodhimit të energjisë elektrike konsiderohen: uji, era dhe dielli, përkatësisht hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet solare.

Opozita: Qeveria të jetë më transparente në diskutimet e marrëveshjeve ndërkombëtare

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës nënshkruan të hënën me qeverinë daneze edhe një letër-

pëlqim tjetër, i cili ka të bëjë me dhënie të 300 qelive të burgut në Kosovë në shfrytëzim për shtetin e Danimarkës.

Zyrtarë të Qeverisë së udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje thanë se diskutimi për këto ka nisur nga Qeveria e mëparshme e Kosovës, e udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Megjithatë, deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se bisedimet është dashur të jenë më transparente. "Nuk ka qëndrim ende LDK-ja. Duhet të analizohet mirë ky nënshkrim. Është dashur të analizohet para se të nënshkruhet", thotë ajo.

Për mungesë të transparencës, qeverinë e kritikon edhe deputetja tjetër opozitare, Ariana Musliu-Shoshi nga Partia Demokratike e Kosovës. "Ne e kemi kuptuar në momentin kur ka dalë në medie, sepse e dini që qeveria nuk është transparente me ne si opozitë. Çdo marrëveshje ndërkombëtare duhet të bëhet në pajtim me opozitën, sepse duhen edhe votat e opozitës", thotë ajo.

Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Albena Reshitaj, njëkohësisht anëtare e Komisionit Parlamentar për Mjedisin, thotë se shpreson që

letër-pëlqimi për investimet në energjinë e ripërtërishme të diskutohet sa më parë në komision.

Dekarbonizimi i energjisë në Kosovë, i dëshirueshëm, por vështirë i arritshëm

Qymyri është burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë, por, shumë shtete të botës synojnë ta heqin nga përdorimi këtë lëndë djegëse, e cila, siç thuhet, rrit ndotjen dhe rrjedhimisht ndikon negativisht në ngrohjen globale. Sipas të dhënave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë (ZRRE), kapaciteti total i gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2020 ka qenë rreth 1 110 megavatë në orë. Nga kjo sasi, 86.5 për qind janë gjeneruar nga termocentralet dhe pjesa tjetër nga hidrocentralet dhe burimet e ripërtërishme të energjisë.

Fadil Ismajli, ekspert i fushës së energjisë, thotë se Kosova do ta ketë vështirë të arrijë furnizimin me rrymë nga burime të ripërtërishme, pavarësisht prej investimeve. "Nëse mendojmë që prej burimeve vendore të ripërtërishme ta bëjmë sigurimin e furnizimit ose ta

mbulojmë konsumin e Kosovës, është pothuajse e pamundur", thotë Ismajli për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, shumica e përmendur si investim i mundshëm nga Danimarka nuk është shumë e madhe kur bëhet fjalë për investime në sistemin e energjisë.

Në matjet që bëhen vazhdimisht, Kosova shpeshherë renditet ndër vendet me ajrin më të ndotur në botë. Egzonia Shala, ambientaliste, e sheh si hap pozitiv investimin dhe interesimin e Danimarkës në çështje të energjisë së gjelbër në Kosovë. Sipas saj, i rëndësishëm në këtë aspekt është edhe investimi në burime njerëzore. "Kosova si shtet ka shumë nevojë për ekspertizë dhe përvojë të marrë nga ekspertët, sidomos nga shtetet si Danimarka", thotë Shala. Ajo pranon se Kosova do ta ketë të vështirë të arrijë mbulimin total të konsumit me burime të ripërtërishme të rrymës, por thotë se energjia e gjelbër duhet të synohet në maksimum.

Kosova është zotuar se do ta bëjë dekarbonizimin ose largimin nga varësia prej qymyrit me anë të nënshkrimit të Marrëveshjes në Samitin e Sofjes në vitin 2020.

Meduza: Një përbindësh mizor, apo një viktimë e keqkuptuar?



Historia e Meduzës nuk është një histori e re. Imazhi i saj njihet thajse nga kushdo. Ajo ka në kokë gjarpërinj të gjallë në vend të flokëve. Pjesa e sipërme e trupit është ajo e një gruaje, ndërsa pjesa e poshtme enjë gjarpri. Ndërkohë sytë e saj mund ta kthenin në gur çdo mashkull që guxonte ta shihte. Shumë heronj u përpoqën ta fitonin kokën e saj si një trofe, por dështuan dhe përfunduan si statuja në ishullin e braktisur të Sarpedonit, të cilin përbindëshi e quante “shtëpinë” e tij. Meduza ishte kundërshtarja kryesore e Perseut, që arriti në fund ta vriste duke ia shkëputur brutalisht kokën nga trupi.

Kjo është me pak fjalë historia e Meduzës. Historia e saj është një temë mitologjike shumë interesante, pasi bart disa tipare të jashtëzakonshme, që nuk gjenden tek asnjë mit tjetër. Edhe sot, mijëra vjet më vonë, vazhdon të ritregohet fati tragjik i Meduzës.

Ky mit përshtatet me nevojat e shoqërisë sonë. Ai përmban disa koncepte klasike si dualiteti i së mirës dhe së keqes, bukuria dhe shëmnia, drejtësia dhe ndëshkimi, të cilat janë të gjitha elemente të domosdoshme të çdo historie madhështore. Në fakt origjina e këtij miti nuk dihet me saktësi.

Meduza përmendet për herë të parë në poemat epike të Homerit, të cilat u shkruan rreth shekullit VIII Para Erës Sonë. Por

miti i saj është shumë më i vjetër, dhe daton ndoshta që nga koha e Mikenasve, qytetërim që e dominoi Greqinë gjatë epokës së bronzit (vitet 3.300-1200 Para Erës Sonë).

Nga burime historike konfirmohet se në kohën e Greqisë së hershme arkaike (vitet 800-600 Para Erës Sonë) Meduza ishte tashmë një figurë shumë e njohur. Ajo përmendet në veprat e Hesiodit dhe poetit Pindar, ndërsa koka e saj përshkruhet në forma të panumërta në disa vepra arti, duke filluar nga qeramika, skulpturat, mozaikët, hajmalitë dhe bizhuteritë.

Një gjetje tjetër interesante është se koka e saj pikturohej zakonisht në mburojat e ushtarëve grekë për të frikësuar armikun dhe për të mbrojtur bartësin e tij. Spartanëve u pëlqente në veçanti përdorimi i këtij simboli, që dekoronte shpesh mburojat e mbretërve dhe gjeneralëve të tyre.

Në fillim Perseu dhe Meduza nuk kishin asnjë lidhje me njëri-tjetrin. Edhe pse Perseu është themeluesi mitologjik i Mikenës, pra një figurë qendrore në panteonin heroik mikenas, ai thuhet se nuk e ka vrarë Meduzën. Por këtij miti i mungon një element thelbësor: Perëndësia Athina.

Në mitin kryesor, Athina vepron si këshilltarja e Perseut, që e këshillon dhe i jep një mburojë të lëmuar për të pasqyruar shikimin vdekjeprurës së

përbindëshit. Kur Meduza vritet, Athina ia merr kokën dhe e vendos në mesin e mburojës së saj si një trofe, por edhe si armë për të trembur armiqtë e saj.

Në variantet e mëvonshme të mitit, në shekujt VI-IV Para Erës Sonë, thuhet se Athina kishte një konflikt personal me Meduzën. Pikërisht në atë kohë kemi një histori të originës së përbindëshit. Meduza ishte dikur një grua e bukur me shumë dashnorë, e cila mburrej se flokët e saj ishin më të bukur se ato të Athinës.

Sipas tregimeve të tjera ajo flinte me Poseidonin brenda tempullit të shenjtë të perëndeshës. Për të ndëshkuar arrogancën e saj, Athina e mallkoi Meduzën duke i shndërruar flokët e saj në gjarpërinj të gjallë, dhe duke e bërë atë që të shndërronte në gurë çdo burrë që shihte.

Pas vdekjes së Meduzës, Athina jo vetëm që e merr kokën si trofe, por edhe identitetin e saj. Ajo shihet si kujdestare e popullit dhe mbrojtëse e jetës shtëpiake. Kur angazhohet në një betejë ajo është e egër, duke u shkaktuar frikë të pakontrollueshme armiqve të saj.

Ndërkaq, në epokën arkaike, poeti grek Pindari ishte i pari që e përmendi fytyrën e bukur të Meduzës. Që nga ajo pikë e tutje, shumë shkrihtarë e përqaftuan këtë ndryshim dhe filluan të përshkruanin një anë më të butë

dhe dashmirës të Meduzës, ku ajo ishte viktimja e tregimit, dhe jo grua e ligë. Ai ndryshim u përqaftua gjerësisht gjatë kohës romake.

Kishte shumë versione, por më i shquari u përshkrua nga Ovidi në librin e tij “Metamorfozat”. Atje mësojmë për herë të parë mbi historinë e përdhunimit të Meduzës nga Poseidoni. Sipas Ovidit: “Ajo ka qenë dikur shumë e bukur, shpresa e shumë njerëzve. Një ditë Neptuni (emri romak i Poseidonit) e gjeti dhe e përdhunoi në tempullin e Minervës. Kështu perëndësia u largua nga tempulli e lënduar, fshehu sytë pas mburojës së saj dhe i ndërroi flokët e saj në gjarpërinj. Dhe për të trembur çdo njeri keqdashës, ajo mban në parzmore nepërkat e saj metalike, si një paralajmërim i tmerrshëm për hakmarrjen e saj”.

Ky është miti që shpjegon origjinën e Meduzës, dhe se si ajo u shndërrua në një përbindësh pasi u fajësua nga Athina pse u përdhunua nga Poseidoni. Arsyeja pse Zoti i fuqishëm i deteve e përdhunoi Meduzën, ishte sepse ai akt shihej si një mënyrë për t’u hakmarrë ndaj Athinës. Kështu ai e përdhosi tempullin e saj të shenjtë duke e dhunuar priftëreshën e tij supreme.

Meduza është pa dyshim një nga qeniet më komplekse të mitologjisë greke. Nga një perëndeshë e pjellorisë, ajo u shndërrua në një demon

kujdestar, më pas në një përbindësh dhe sërish në një grua përbindësh të bukur, e cila u bë simboli i grave të dhunuara në mbarë botën.

Edhe sot ajo vazhdon të prezantohet në shumë forma të ndryshme të artit, duke iu përshtatur stileve më të reja. Ajo është simbol i shumë organizatave feministe, një kujtesë e vazhdueshme e shtypjes, sulmit seksual dhe trajtimit të padrejtë. Në ritregimet moderne të mitit, Meduza është gjithashtu një luftëtare, të cilën Athina e bekon duke i dhënë asaj “vështrimin e gurtë” në mënyrë që të mbrohet dhe të mos lejojë më kurrë të lëndohet nga një burrë tjetër.

Në botën tonë moderne, ku krimet seksuale kundër grave janë fatkeqësisht ende të pranishme, mite të tilla janë shumë të rëndësishme. Konceptet si fajësimi i viktimës, dënimi i aktit të turpshëm të përdhunimit pa marrë parasysh identitetin e kriminelit, dhe akti i vetëmbrojtjes dhe rimëkëmbjes personale pas një incidenti të tillë, duhet të mësohen në mbarë botën.

Ndoshta ka ardhur koha të ndalojmë së adhuruarin princeshën e stilit Disney, dhe të nisim t’u kushtojmë më shumë vëmendje këtyre përbindëshave të keqkuptuar, historitë e të cilëve kanë kaq shumë për të na mësuar rreth botës.

Marrë me shkurtime nga History of Yesterday – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, të parat në ranglistën botërore



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Bota e xhudos po "sundohet" nga vashat dardane. Pas përditësimit të Ranglistës Botërore në këtë sport, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova janë në vendin e parë në kategoritë përkatëse. Këtë lajm e ka bërë me dije "Kosovo Judo Federation" përmes një postimi në "Facebook". "Kosova dominon prapë në botë. Pas përditësimit të ranglistës botërore, dy kampionet tona olimpikë janë në vendin e parë", shkruhet në postim.

Distria është në vendin e parë në botë, në kategorinë -48 kilogramë, me gjithsej 5 920 pikë, kurse Nora ka gjithsej 5 880 pikë dhe është e para në kategorinë -57 kilogramë. Ky është edhe një sukses i madh për kampionet olimpikë. Ditë më parë Distria ishte zgjedhur xhudistja më e mirë në botë nga Komiteti Olimpik i Xhudos, pas votimit online. Ndërsa Driton Kuka u zgjodh trajneri më i mirë në glob. Krasniqi ishte e jashtëzakonshme në Lojërat Olimpikë të mbajtura në

Tokio. 25-vjeçarja është medalistja e dytë e artë olimpikë e Kosovës, pas Majlinda Kelmendit, e cila ishte shpallur kampione në "Rio 2016". Distria kishte mposhtur në finale xhudisten japoneze Funa Tonakin, kurse Gjakova kishte mposhtur në gjysmëfinale japonezen Tskukasa Yoshida që ishte pretendentja kryesore në peshën deri në 57 kg, ndërsa në finale e kishte "gjunjzuar" xhudisten franceze Sarah Leonie Cysique, me ippon.

Phoenixi ruan kreun në Perëndim

LOS ANXHELOS, 22 DHJETOR - Phoenixi ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 108-90 në fushën e lakersave. Fitorja e katërt radhazi për Suns-in, ku 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Bookerit me 24 pikë ishte më i miri për Phoenixin, duke i bërë të pavlefshme 34 pikët e LeBron Jamesit



për lakersat. Fitoi edhe skuadra e Miamit, që mundi 125-96 Indianan, sfidë ku Herro e Robinson realizuan nga 26 pikë secili për ekipin nga Florida. Rikthehet te fitorja Dallasi, që

mundi 114-102 Minnesotan (Brunson 28 pikë), ndërsa New Orleansin mposhti me rezultat 111-97 Portlandin (Ingram 28 pikë e Walker 27).

REZULTATET

Miami - Indiana	125-96
New York - Detroit	105-91
New Orleans - Portland	111-97
Dallas - Minnesota	114-102
Lakers - Phoenix	90-108

SHKURT

Daja, pas interesimit të Ballkanit: Kam një kontratë me Partizanin

Skuadra e Ballkanit mori një vendim befasues kur shkarkoi trajnerin Bekim Isufi. Isufi e la Ballkanin në pozitën e dytë në tabelë me vetëm dy pikë larg vendit të parë, por kjo nuk mjaftoi për drejtuesit therandas që e ndërprejnë bashkëpunimin me të. Menjëherë pas kësaj nisën zërat për trajnerin e ri. Demokracia.com mësoi se klubi nga Suhareka është interesuar për trajnerin e Partizanit, Ilir Daja. Vetë trajneri nuk e ka mohuar një mundësi largimi nga Partizani, ndërsa nuk ka folur nëse ka apo jo kontakte me klubet e tjera. "Unë kam një kontratë me klubin, por nuk më mban kontrata te Partizani. Më mbajnë marrëdhëniet bilaterale me drejtuesit, që janë shumë të mira", ka përfunduar Daja.

Peja, sulmin më të mirë në Ligën Unike për stinorin vjeshtor

Ka përfunduar stinori vjeshtor në Ligën Unike të meshkujve, me Golden Eagle Yllin, që u shpall kampion vjeshtor. Sulmin më të mirë e kishte Peja, me 671 pikë të shënuara në shtatë ndeshje të zhvilluara apo 95.8 pikë për ndeshje. Në vendin e dytë sa i përket efikasitetit ishte Teuta e Durrësit me 648 pikë dhe Rahoveci i treti me 617. Më së paku pikë në shtatë ndeshje ka shënuar Vllaznia e Shkodrës, 539 ose 77 pikë për ndeshje. Mbrojtjen më të mirë e ka Golden Eagle Ylli, që ka pranuar 507 pikë ose 72.42 pikë për ndeshje, ndërsa mbrojtjen e dytë më të mirë e kishte Peja me 550 pikë të pranuar. Ylli u shpall kampion vjeshtor me gjashtë fitore dhe një humbje, kurse Vllaznia e Shkodrës ishte në vendin e fundit me një fitore dhe gjashtë humbje.

Pas Barçës, West Hami kërkon Januzajn

Skuadra e West Ham Unitedit ka shprehur interesim për futbollistin e Real Sociedadit, Adnan Januzajn. Barcelona kishte kërkuar të nënshkruajë me Januzajn për të cilin nuk do të ketë nevojë të paguajë dëmshpërblim, pasi 26-vjeçarit i skadon kontrata me klubin spanjoll në fund të sezonit. Bëhet me dije se West Hami është në avantazh, pasi trajneri David Moyes ka punuar me Januzajn te Manchester Unitedi, madje i ka dhënë hapësirë të madhe në edicionin 2013/2014. Në këtë sezon Januzaj ka shënuar dy gola dhe po aq asistime në 25 ndeshje në të gjitha garat.

Flamurtari vazhdon serinë pozitive, mposht Prishtinën

Flamurtari ka shënuar fitore ndaj Prishtinës me rezultat 64:57 (20:15, 11:14, 19:12, 14:16) në xhiron e pestë të Ligës Unike në konkurrencën e femrave, që është e fundit për stinorin vjeshtor. Vendaset e filluan ndeshjen më mirë. Ato në çerekun e parë ishin për një nuancë më të mira dhe e fituan këtë pjesë 20:15. Prishtinaset përgjigjen shpejt për ta barazuar rezultatit dhe gjatë gjithë kësaj pjese zhvillohet një lojë e barabartë, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 31:29. Basketbollistet e Flamurtarit ishin më të mira në periodën e tretë, duke arritur epërsi prej dhjetë pikësh, 43:33, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 50:41. Në dhjetë minutat e fundit skuadra vlonjate ruajti epërsinë e krijuar për të triumfuar në fund me shifrat 64:57. Obryan Michelle ishte më e dalluara te Flamurtari me 16 pikë, dhjetë kërcime dhe dhjetë asistime, kurse te Prishtina Arbore Përquku shënoi 15 pikë, ndërsa Sarah Mgbeike realizoi 14. Flamurtari e përfundoi stinorin vjeshtor me katër fitore dhe një humbje, ndërsa Prishtina me tri fitore dhe dy humbje.

Lewandowski: Fjalët e Messit për mua nuk ishin fjalë boshe

MUNCHEN, 22 DHJETOR - Robert Lewandowski ka sqaruar se fjalët e Lionel Messit drejtuar atij në ceremoninë e "Topit të Artë" e prekën atë vërtet. Messi e pranoi se Lewandowski është dashur ta fitonte të paktën një Top të Artë deri tani në karrierën e tij, duke e parë shkëlqimin e tij në fushë për

Bayern Munchenin. Në një intervistë pas ceremonisë, Lewandowski ishte cituar të kishte thënë se fjalët e Messit ishin boshe, gjë të cilën e mohoi menjëherë sulmuesi polak. Dhe tani, në një bisedë me gazetën gjermane "Bild", Lewandowski ka thënë se fjalët e Messit nuk ishin

aspak boshe, por do të mbetet një çast i këndshëm në karrierën e tij. "Fjalët e Messit drejtuar mua (për Topin e Artë) më prekën vërtet. Ato nuk ishin fjalë boshe. Ishte një çast i këndshëm në karrierën time", ka thënë Lewandowski për "Bild". "Me Leon i ndërrova vetëm disa llafe, sepse spanjishtja ime

nuk është aq e mirë. Fola me Kylian Mbappen në anglisht, ai përktheu për Leon. Ishte një natë madhështore", ka shtuar sulmuesi polak. I pyetur se çfarë duhet të bëjë ai për ta fituar "Topin e Artë" në të ardhmen, Lewandowski ka deklaruar: "Hollësitë janë të rëndësishme, çdo gjë duhet të jetë



në vendin e vet. Çfarë mund të garantoj unë është se do të vazhdoj ta bëj punën time dhe të luaj sa më mirë".

Sadiku: Broja e meriton të jetë titullar

TIRANË, 22 DHJETOR - Konkurrenca e pamëshirshme nuk është "halli" i vetëm i sulmuesve të kombëtares së Shqipërisë. Një pjesë e mirë e tyre kanë pasur një raport të vështirë me trajnerin Edi Reja. E kemi fjalën për Brojën, Kamberin dhe Vrionin, por ndonjë tjetër nuk ka asnjë raport me të. Ky është rasti i Armando Sadikut, bomberit kuqezi që hyri në histori me golin e shënuar në Evropianin e 2016-s, por edhe me 12 golat që ka shënuar me fanellën e Shqipërisë në 38 ndeshje. Një sulmues race që ka qenë i pafat në sezonet e fundit, por është ndier më i zhgënjyer që nuk ka marrë asnjë telefonatë nga trajneri apo stafi kuqezi në çastet e tij më të vështira. "Nuk më ka kontaktuar kurrë. Ndihej keq, sepse të gjithë kalojmë vështirësi, por kur askush nuk të telefonon, atëherë nuk di çfarë të mendosh", ka thënë Sadiku në intervistën ekskluzive për "Panorama Sport".



A ju mungon kombëtarja?

Sadiku: Normalisht që më mungon shumë. Që nga momenti që unë ika në Bolivi, sikur u largova pak nga kombëtarja dhe humba kontaktet edhe me drejtuesit.

Keni folur ndonjëherë me trajnerin Edi Reja?

Sadiku: Trajneri Edi Reja që kur ka ardhur në drejtimin e kombëtares shqiptare nuk më ka marrë asnjëherë, nuk kam folur kurrë me të.

Në të kaluarën ka ndodhur shpesh që lojtarët të cilët kanë hasur probleme i kanë thirrur në ekipin përfaqësues për t'u dhënë një dorë...

Sadiku: Ju a ndiheni i kënaqur me mënyrën si ju kanë trajtuar së fundmi? Nuk e di se çfarë është bërë me lojtarët e tjerë, unë flas për veten time. Që kur është emëruar Edi Reja në stol, unë nuk kam marrë asnjë telefonatë.

Madje as të më pyesë: "Si je?" apo "Si shkojnë gjërat?" Nuk ka pasur asnjë interesim nga ana e tij. Kaq.

Ju, Kamberi, Vrioni dhe, së fundmi, Broja... a e keni menduar ndonjëherë se përse "problemet" Reja i ka me sulmuesit?

Sadiku: Janë disa gjëra që nuk arrij t'i kuptoj. Nën urdhrat e Edi Rejes kam qenë vetëm dy grumbullime dhe nuk kam pasur asnjëherë mundësi që të paktën të flas me të, qoftë edhe një bisedë tek për tek. Unë jam shumë i shoqërueshëm me lojtarët e kombëtares, i kam të gjithë shokë dhe flas shpesh me ta. Më kanë thënë që asnjë nga ata nuk kanë kontakt me Edi Rejen. Është tip që nuk komunikon me lojtarët. Ndërsa për rastin e Armando Brojës, unë kam thënë që në momentin që ka ardhur në kombëtare është një supersulmues dhe për mua e meriton që të jetë titullar çdo ndeshje.

SHKURT

Xavi: Ndaj Sevilas humbëm dy pikë

Skuadra e Barcelonës nuk shkoi më shumë se një barazim në transfertë kundër Sevilas (1-1). Trajneri Xavi është shfaqur i zhgënjyer, pasi ka shprehur besimin se skuadra e tij e ka merituar fitoren. "Mendoj se kemi humbur dy pikë, sepse ne e merituar më shumë. Ne duhej të fitonim, i kishim mundësitë. Në pjesën e parë luajtëm shumë mirë, me personalitet, me qarkullim topi dhe presion kur e humbim. Jemi përmirësuar në shumë aspekte, por nuk qe e mundur të fitonim. Luftuam fort dhe jam krenar për ekipin. Mendoj se e meritonim të fitonim. Ndonjëherë duhet të kemi më shumë durim dhe pjekuri për ta kuptuar më mirë lojën. Do të më lërë pa gjumë ky barazim, sepse i meritonim tri pikët. Gjithsesi, ne jemi në rrugën e duhur dhe kjo skuadër po i afrohet më shumë Barcelonës që unë e dua", ka thënë Xavi.

Kupa e Afrikës do të zhvillohet sipas programit

Kupa e Afrikës do të zhvillohet rregullisht sipas programit nga data 9 janar deri në 6 shkurt të vitit 2022 në Kamerun. Diçka të tillë e ka konfirmuar presidenti i Konfederatës Afrikane të Futbollit, Patrice Motsepe, pas takimit që ky i fundit ka pasur me kreun e shtetit Paul Biya. "Unë do të mbërrij në Kamerun më 7 janar për të luajtur dhe për të parë futboll dhe do të jem në stadiumin Olembe më 9 bashkë me familjen time për ta ndjekur sfidën Kamerun-Burkina Faso. Do të jem në Kamerun edhe më 6 shkurt për ta dorëzuar trofeun, të cilin miku im Samuel Eto'o mendon se do ta fitojë Kameruni, ndërsa presidenti i Federatës së Senegalit mendon të kundërtën", ka deklaruar Motsepe.

Juve në janar e dëshiron Aubameyangun

Sulmuesi i Arsenalit, Pierre-Emerick Aubameyang, mund t'i bashkohet Juventusit.

"Zonja e Vjetër" kërkon të përfitojë nga mosmarrëveshjet midis drejtuesve të Arsenalit dhe sulmuesit Aubameyang. Pikërisht këtë situatë duan t'i shfrytëzojnë italianët për ta bindur lojtarin të kalojë në Torino që në janar. Drejtuesit e bardhezinjve synojnë ta marrin sulmuesin fillimisht në formë huazimi deri në fund të sezonit për ta blerë më pas përfundimisht.

Reali e shet Hazardin për 35 milionë euro

Eden Hazardi nuk është në planet e Real Madridit dhe mund të largohet në afatin kalimtar të janarit. Sipas Fichajes, Reali kishte shpresuar që ta shesë yllin belg për 50 milionë euro, por tash është i gatshëm të heqë dorë nga ai edhe për një shumë më të vogël, pra për 35 milionë euro. Në fillim të këtij muaji, gazeta spanjolle "El Nacional" pretendoi se Madridi kishte refuzuar një ofertë prej 25 milionë eurosh për Hazardin nga West Ham Unitedi. Newcastle dhe Evertoni kanë qenë gjithashtu të lidhur me ish-anësin e Lilles. "El Nacional" pretendon se Hazardi tashmë ka refuzuar një mundësi për t'u transferuar në "St James' Park" me një kontratë fitimprurëse.

Mick Schumacher te Ferrari si pilot rezervë

Mick Schumacher do të jetë piloti i tretë i Ferrarit për vitin 2022, duke qenë piloti rezervë i "kokëkuqes". Ai do të garojë me makinën amerikane Haas, si pilot zyrtar i saj, por në rast se

Ferrari do të ketë nevojë për të, ai do të garojë me "kokëkuqen" (në rast dëmtimi të Leclerc apo Sainz). Lajmin e konfirmoi drejtori sportiv i Ferrarit, Mattia Binotto:

"Mos harroni si ai është pilot i Ferrarit, është pjesë e akademisë sonë. Kjo akademi zbulon talentet dhe pilotët e ardhshëm të Ferrarit. Nëse je pjesë e akademisë dhe je i

suksesshëm, atëherë do ta kesh mundësinë të pilotosh edhe Ferrarin në garë". Te makina italiane synojnë në rritjen profesionale të 22-vjeçarit gjerman, që këtë vit debutoi në Formula 1 me

Haas, makinën më të dobët të këtij botërori. Ai nuk grumbulloi asnjë pikë. "U paraqit mirë dhe pati përparim në pistë, jo vetëm në vijueshmëri, por edhe në shpejtësi", ka thënë Binotto.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 1226/01
Dt. 12.22.2021

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022 KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL - MESIMI PER TE RRIUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në QK "11 Marsi" në Prizren, shpallim këto drejtime:

I. Makineri		
1	Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit	1 Paralele 24 nxënës
2	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	1 Paralele 24 nxënës
3	Automekanik	1 Paralele 24 nxënës
4	Dizajn i Metaleve	1 Paralele 24 nxënës
II. Ndërtimtari		
1	Arkitekturë	1 Paralele 24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele 24 nxënës
3	Gjeodezi	1 Paralele 24 nxënës
III. Artet e aplikuar		
1	Dizajn Veshje	1 Paralele 24 nxënës
2	Dizajn Grafik	1 Paralele 24 nxënës
IV. TRANSPORT		
1	Trafik Rugor	1 Paralele 24 nxënës
V. Elektroteknikë		
1	Dizajn Softuer,	1 Paralele 24 nxënës
2	TIT	1 Paralele 24 nxënës
3	Informatikë	1 Paralele 24 nxënës
4	Instalues Elektrik	1 Paralele 24 nxënës
5	Makina Elektrike	1 Paralele 24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkollë profesionale, për vitin shkollor 2019/2020, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:


Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës QK "11 Marsi" në Prizren, nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse 3(tri) ditë pas mbylljes së konkursit.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.



Kryetari i Komunës - Suharekë 01-nr.464, 77673 Dt. 16. 12. 2021

Ne kuptim të nenit 11, lidhur me nenin 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme Nr.03/L-139 dt. 26.mars 2009 të Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme nr.03/L-205 dt.10.dhjetor 2010, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative O/L-031, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklarave të palëve, brenda afatit ligjor, si dhe duke u bazuar Vendimin për shqyrtimin e mëtej të kërkesës për shpronësim 01 nr.464-40195, dt. 15.07.2021, Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit të propozuar 01. nr.464-69186 dt. 05.11.2021 për shpronësimin e palujtshmerisë për ndërtimin e kanalit për ujra dhe rrugës publike në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I.Shpronësohet palujtshmeria për interes publik dhe për ndërtimin dhe për ndërtimin e kanalit për ujra dhe rrugës publike e cila gjindet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116046-01895-1, në sip. prej: 1259 m² në vendin e quajtur "Jazi-Osoja" e evidentuara sipas qertifikatës së pronë emër të **Nehat (Rasim) Berisha , ZK. Suharekë.**

II. Vërtetohet se ndërtimi i kanalit për ujra dhe rrugës publike në Suharekë është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe së shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

III. Pronari i palujtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, kompenzohet konform Aktit- vlerësimit të punuar nga Zyra e Departamentit për Vlerësimin e Pronës së Palujtshme-Ministra për Financa në Prishtinë, në shumën prej: 28.00 €/m² (njzet e tet eu), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 1259 m², kompenzohet në shumën totale prej: 35,252.00 €. (Tridhjet e pes mijë e dyqind e pesdhjet e dy euro).

IV. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Arsyetim

Subjekti kërkues-Drejtorja për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës, me kërkesën 01 nr.104-37719, datë 05.07.2021, ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për realizimin e projektit për ndërtim dhe zgjerimin e rrugës publike dhe kanalit për ujra të evidentuara si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Subjekti kërkues, kësaj kerkese ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitat e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka konstatuar se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtij qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme.

Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkues dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkues për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 15 ditëve kalendrike pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi i dergohet:

Subjektit kërkues, Pronarit,
zotëruesit të interesit dhe arkivës



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Hopede" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811328667, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Hopede" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811328667 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Hopede" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811328667 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besart Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

